



KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

Thirrje gjithë Shqiptarëve në Malin e Zi

27/08/2020

Këshilli Koordinues i Diasporës ndjek ngaherë me vëmendje të veçantë zhvillimet politike në hapësirën Shqiptare në Ballkan. Situata e jashtëzakonshme e pandemisë po krijon sfida të jashtëzakonshme politike dhe ekonomiko-sociale, pasojat e te cilave do ndjehen për shumë vite.

Dy dekadat e fundit shqiptarët në Ballkan janë bërë faktor i rëndësishëm duke luajtur një rol politik të veçantë. Kjo pozitë mund të ruhet dhe forcohet vetëm përmes bashkëpunimit të shqiptarëve mes njeri-tjetrit me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre jetike dhe demokratike.

Zgjedhjet e 30 Gushtit në Mal të Zi janë të rëndësishme për forcimin e demokracisë dhe integritimit në BE dhe njëkohësisht një sfide bashkëpunimi për Shqiptarët që jetojnë atje. Shqiptarët e Malit të zi përbëjnë rreth 5% të popullsisë, një ndër 5 grupet më të mëdha etnike në vend, por me një përfaqësim të dobët në parlamentin aktual. Që shqiptarët të jenë faktor dhe të mbrojnë interesat e tyre në institucionet malazeze, duhet të jenë të bashkuar dhe në rastin konkret të votojnë për listat e përbashkëta shqiptare.

Jemi të bindur se duke votuar për listat Shqiptare ata forcojnë pozitën e tyre, duke forcuar në të njëjtën kohë të ardhmen Europiane dhe pozitën e Malit të Zi në rajonin tonë.

Ju bëjmë thirrje gjithë shqiptarëve në Ulqin, Plavë, Gucie, Tuz, Krajë të votojnë masivisht për përfaqësuesit e tyre shqiptarë, për të ardhmen e tyre.

Në këto çaste kritike le të kujtojmë fjalët e mençura të Shenjtores sonë kombëtare, Nënë Terezës:

“Unë mund të bëj gjëra që ti nuk i bën dot. Ti mund të bësh gjëra që unë nuk i bëj dot. Të bashkuar mund të bëjmë gjëra të mëdha”.